



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/36

Datë: 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet nga mbledhjet; 04, 05, 06, 07, 08 dhe 09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet elektronike\korresponduese; 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/36

Datë: 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë si në vijim:

- I. Plotësohet dhe ndryshohet pika e 4. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/15 i datës 23/03/2020 me të cilin janë ndaluar tubimet në të gjitha mjediset publike dhe private si në vijim:
  1. Ri-hapen faltoret (xhamia dhe kisha) me numër të reduktuar të besimtarëve në raport me sipërfaqet e faltoreve;
  2. Obligohen t'i përmbahen rekomandimeve të IKShPK-së dhe OBSH-së duke mbajtur distancë, maska dhe higjienë personale, nën mbikëqyrje vetanake të faltoreve, të inspektorateve komunale dhe organeve të vendit;
- II. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik të reduktuar, krahasuar me situatën paraprake, e konstatuar nga IKShPK-ja dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/36  
Datë: 27.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Objektivit të Pikë-kalimit kufitar të përbashkët mes Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, Zona Kadastrale Stançiq, Komuna e Gjilanit, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe Transfereve, pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interes, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, i dërgon vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelën pjesë përbërëse e këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë